



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 12936 Prot

Shkodër, më 27.07.2021

Lënda: Në përgjigje të kërkeses për informacion mbi trajtimin e qenve endacake

KËSHILLIT BASHKIAK

Lidhur me kërkesën për informacion mbi procesin e trajtimit të qenve endacakë, kërkesë e bërë në mbledhjen e fundit të Këshillit bashkiak ju informojmë se:

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 10465, datë 29.09.2011 " Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, V.K.M. nr. 230 , datë 20.03.2013 "Për përcaktimin e funksioneve, detyrave specifike dhe standarteve të shërbimit veterinar të qeverisjes vendore", si dhe në angazhimet e marra në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Shëndetit të Kafshëve (OIE), Kapitulli 7.7 i Kodit të Shëndetit të Kafshëve të Tokës për kontrollin e popullatës së qenve endacakë, mbështetur në kërkesën e Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave nr 1067 datë 13.02.2017 për "Hartimin e strategjisë për administrimin e qenve endacake" , Bashkia Shkodër ka hartuar Planin e Veprimit për trajtimin e qenve endacake (pa pronarë) në territorin e Bashkisë Shkodër.

Ky plan veprimi përfshin:

1. Kapjen e qenve të identifikuar dhe trajtimin e tyre. Trajtimi konsiston në sterilizimin dhe kastrimin e tyre, vaksinimin kundër tërbimit (KSV), trajtimin antiparazitar kundra ekinokokut dhe matrikullimin e tyre për efekt regjistrimin në databasen që disponon Bashkia Shkodër.
Deri në fund të vitit 2020 janë trajtuar rreth 1400 qenë endacakë dhe është në proces trajtimi i 300 të tjerëve.
2. Per here te pare po zbatohet projekti pilot per identifikimin e qenve me pronar nepermjet paisjes me chip elektronik duke krijuar një bazë të dhënash të saktë.

Nga viti 2016 deri 2020 nga Bashkia Shkoder ka akorduar fond prej 1 milion leke çdo vit buxhetor për trajtimin e qenve endacakë. Per 2021 fondi i akorduar eshte **dyfishuar** ne 2 milione leke.

3. Në bashkepunim me organizatat që operojnë në Bashkinë Shkodër si: "Animals Needs Me", "Pro Qen Albania" si dhe me fondacionin "Stray Cooco" është bërë i mundur trajtimi i qenve të sëmurë në strehëzën që organizata menaxhojnë, për periudha afatshkurta, deri në shërimin e plotë të tyre. Në raste të pashërueshme bëhet eliminimi me eutanazi duke përfshirë edhe qentë që evidentohen me shfaqje agresiviteti në rrugë.

Gjatë këtyre viteve, përmes trajtimit është krijuar një bazë të dhënash e plotë, duke përfshirë të gjithë procesin e zbatimit të metodës KSVL, e cili përmban :

- Datën e kapjes
- Foto të qenit në përfundim të procesit
- Numri i matrikullit
- Gjinia
- Moshë
- Zona e kapjes (lëshimi bëhet në zonën e kapjes)
- Personi përgjegjës që ka realizuar kapjen dhe lëshimin
- Trajtimet e kryera (sterilizim, vaksinimi, dehelmetizimi)

Procesi monitorohet nga stafi veteriner i Bashkisë Shkodër.

3. Shpesh vërehet një numër i prurjeve të qenve endacakë kryesisht nga bashki të tjera të hedhur në territorin e Bashkisë Shkodër, apo edhe braktisja e tyre nga pronarët. Për këtë kërkohet një vëmendje e shtuar nga ana e agjensive ligjzbatuese si Policia e Shtetit, Inspektoriati Veterinar, por edhe sensibilizim dhe monitorim i punës së bashkive të tjera, në mënyrë që fenomeni i "transferimit" të kuptohet që nuk është zgjidhje, por e përkeqëson problematikën.

Ne mënyrë që të reduktohet ky fenomen është kërkuar nga ana e Bashkisë Shkodër të hartohet një strategji kombëtare veprimi.

5. Krijimi i një strehëze për kafshet endacake është një metodë, e cila aktualisht është vlerësuar e pamundur nga specialistët, kjo për shkak të numrit të madh të kafshëve dhe kostos financiare shumë të lartë të kërkuar për administrimin e një strehëze të tillë. Ngritja e kesaj strehe do vlerësohet në vijim pasi me trajtimet KSVL parashikojmë të reduktohet numri i qenve endacakë. Kjo bazohet në eksperiencat e vendeve të tjera të rajonit.

Bashkia Shkodër mirëpret çdo iniciativë bashkëpunimi dhe sugjerimesh nga ana Juaj, për të arritur edhe më shpejt drejt një zgjidhje përfundimtare të këtij problemi mjaft shqetësues në territor, konform ligjeve në fuqi.

KRYETAR
VOLTANA ADEMI

